# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-471850**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Rrethrrotullimi” i ri i Kukësit i lë të gjithë pa fjalë, asfalt me ngjyra për orientim |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394307.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 15:15:16 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 26 shtator 2026, 15:05:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 26 shtator 2026, 15:04:00 UTC → 26 shtator 2026, 15:06:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a18a370954c7bdb3f8d4239a5dfc6f8800a7c1c327c814adf9d9420154193d1e` |
| TEKSTI | `ddf76a50704d8f7d6f3e0f2185185d71d2bee49a91db1642165449674f87d3b7` |
| PAMJA | `b593ed3ca919034cc5c911a7f451c18f520bdeeda7b0d003507b9d9f128e7ba1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e4a2b4d6783f0a40c279ca20681a93b7fbcfe5ef45315a5a41bb13e53e01bd23` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c646a932fde53c288233dea515333d4375993381cb212e1a0a5e6c9db33460b4` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e4a2b4d6783f0a40c279ca20681a93b7fbcfe5ef45315a5a41bb13e53e01bd23`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "Rrethrrotullimi" i ri i Kukësit i lë të gjithë pa fjalë, asfalt me ngjyra për orientim

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 26.09.2026, 17:05

Share Share





Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Një "investim" i ri në rrugët e Kukësit ka shkaktuar reagime dhe komente nga qytetarët.

Bëhet fjalë për një rrethrrotullim të ndërtuar së fundmi në zonën e Shotës vetëm me asfalt dhe ngjyra orientuese.

Por ajo që ka tërhequr më shumë vëmendjen është mënyra se si është realizuar. Qytetarët e kanë cilësuar si një "gungë me asfalt" dhe pyesin me ironi:

"Jemi në Indi apo në Shqipëri?"

Në denoncimin e mbërritur pranë JOQ, ngrihet edhe pyetja se përse nuk investohet më shumë në kamera dhe masa për kontrollin e shpejtësisë, në vend të ndërhyrjeve të tilla.

Qytetarët i bëjnë thirrje institucioneve përgjegjëse që të japin një shpjegim për këtë rrethrrotullim që po bën xhiron e Kukësit.

**Denoncimi i qytetarit:**

*Përshëndetje JOQ! Kjo që po ndodh në Kukës është për të ardhur keq. Nuk po kuptojmë më nëse jemi në Indi apo në Shqipëri, me këto rrethrrotullime dhe ndërhyrje që po bëhen nëpër rrugë. A ka shtet apo jo? Ju lutem, shpërndajeni anonim, që ndoshta ta shohin edhe ata që kanë përgjegjësi për Kukësin. Fatkeqësisht, duket sikur vetëm kur denoncohen publikisht problemet merren më seriozisht. Në zonën e Shotës në Kukës është bërë së fundmi një rrethrrotullim i ri, me asfalt të ngritur si një lloj gunge, bordura dhe ngjyra për orientim. Në vend që rruga të jetë e rregullt dhe e përshtatshme për qarkullim, është bërë një tjetër pengesë për drejtuesit e automjeteve. Ironia është se thuhet gjithmonë se nuk ka fonde për kamera për kontrollin e shpejtësisë dhe për të gjobitur ata që shkelin rregullat, ndërkohë që për bordura dhe ndërhyrje të tilla në rrugë duket se gjenden para. Kukësi nuk është fshat. Qytetarët meritojnë rrugë të sigurta dhe infrastrukture të bërë siç duhet, jo ndërhyrje që ngrejnë më shumë pikëpyetje sesa zgjidhin probleme.*

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.